



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Kandidatët pjesëmarrës për aplikim për licencë të KPM-së, në bazë të konkursit të shpallur më 14 prill 2016, për Komunën e Gjilanit:

Kandidati: N.SH. "Media 7 Kosova"
Nr. i biznesit: 70795000
Përfaqësuar nga: z. Kushtrim AJVAZI
Emri i propozuar: "Radio 7"
Adresa: Rr/Gjergj Fishta nr. 28
Prishtinë
Kodi i kandidatit: R1

Kandidati: "Radio Gjilani 1" SH.P.K.
Nr. i biznesit: 71233669
Pronari: z. Gani KORÇA
Emri i propozuar: Radio Gilani 1
Adresa: Bulevardi i Pavarsisë p.n
Gjilan
Kodi i kandidatit: R2

Ref: 1606/758/LIC/II

VENDIM

për licencimin e kandidatit R2, për transmetim të radio programeve, me mbulim që i përket kategorisë lokale, në Komunën e Gjilanit

Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.
2. Në bazë të Ligjit nr. 04/L-44 (Ligji për KPM), neni 3, paragrafi 2.1. të, KPM licencon transmetuesit publik e privat dhe i ripërtërin licencat, duke iu dhënë subjekteve të autorizuar të drejtën e përdorimit të frekuencave në Spektrin e Frekuencave të Transmetimit si dhe licencon të gjitha shërbimet mediale audiovizuale.
3. Neni 3, paragrafi 2.6. i ligjit për KPM, i jep kompetencë dhe e obligon KPM-në që të nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat shërbejnë për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.

4. Në pajtim me nenin 23, paragrafi 1 i Ligjit për KPM, më 14 prill 2016, KPM ka shpallur konkurs publik për dhënien e licencave të reja për transmetim të programeve në radio, për Komunën e Gjilanit. Konkursi publik ka qenë i hapur deri më 16 maj 2016.
5. Konkursi publik është zhvilluar mbi bazën e akteve nënligjore të KPM-së, të nevojshme për plotësimin dhe parashtrimin e aplikimit për licencë të KPM-së që janë 1. Rregullorja për dhënien e Licencës së KPM-së (KPM-2013/04); 2. Rregullorja për vlerësimin e aplikacioneve (KPM-2014/02) dhe 3. Rregullorja për nivelin dhe mënyrën e pagesës së taksës për licencë (KPM-2014/03).
6. Me datën 16 maj 2016, të dy kandidatët, R1 dhe R2, kanë dorëzuar aplikacionet e kompletuar në KPM, në pajtim me konkursin publik.
7. Në mbledhjen e mbajtur më 14 qershor 2016, duke u bazuar në nenin 23, paragrafi 4 të ligjit për KPM, Komisioni ka marrë vendim për zgjatjen e afatit edhe për 60 ditë shtesë, për vendosje lidhur me dhënien apo refuzimin e licencave për kandidatët të cilët kanë marrë pjesë në konkursin publik.

Arsyetim

8. Vendimi i KPM-së për dhënien e licencave të reja është bërë mbi bazën e nevojave të publikut dhe kapaciteteve të lira frekuencore në ato komuna të Republikës së Kosovës, ku është vlerësuar se ka mungesë të shërbimeve mediale radio me mbulim lokal, si dhe në ato komuna ku është kërkuar që të krijohet mundësi për pluralizëm medial.
9. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit për KPM, thekson se: *"Për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja"*.
10. Në takimin e mbajtur më 18 maj 2016, Komisioni për Verifikim të Aplikacioneve vlerëson se, aplikacionet e të dy kandidatëve, R1 dhe R2 janë dorëzuar të kompletuar në KPM dhe në pajtim me Rregulloren KPM-2013/04, duke i plotësuar në tërësi kushtet kualifikuese për licencë të KPM-së.
11. Neni 22, paragrafi 4, pikat: 4.1, 4.2, 4.3, 4.4 dhe 4.5 të Ligjit për KPM-në, përcakton kriteret kryesore mbi bazën e të cilave KPM vlerëson aplikacionet e kandidatëve për dhënien e licencës së KPM-së.
12. Më 22 qershor 2016, Komisioni për Vlerësim të aplikacioneve, mbi bazën e kriterëve të përcaktuara sipas nenit 22, paragrafi 4 të ligjit të KPM-së, si dhe në bazë të Rregullores KPM-2014/02, ka vlerësuar kandidatin R1 me 28 pikë për *Kapacitetin për Zhvillimin e Programit Vetanak dhe Nevojën për të Siguruar Program të Shumëllojshëm për të gjithë Qytetarët në atë Zonë të Mbulimit*; me 25 pikë për *Kushtet Teknike* dhe me 25 pikë për *Qëndrueshmërinë Financiare*.

13. Komisioni konstaton se kandidati R1 ka grumbulluar gjithsej 78 pikë gjatë vlerësimit të kriterëve profesionale të përcaktuara me ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.
14. Më 22 qershor 2016, Komisioni për Vlerësim të aplikacioneve, mbi bazën e kriterëve të përcaktuara sipas nenit 22, paragrafi 4 të ligjit të KPM-së, si dhe në bazë të Rregullores KPM-2014/02, ka vlerësuar kandidatin R2 me 34 pikë për *Kapacitetin për Zhvillimin e Programit Vetanak dhe Nevojën për të Siguruar Program të Shumëllojshëm për të gjithë Qytetarët në atë Zonë të Mbulimit*; me 25 pikë për *Kushtet Teknike* dhe me 30 pikë për *Qëndrueshmërinë Financiare*.
15. Komisioni konstaton se kandidati R2 ka grumbulluar gjithsej 89 pikë gjatë vlerësimit të kriterëve profesionale, të përcaktuara me ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.
16. Mbi këtë bazë, Komisioni i Vlerësimit të aplikacioneve ka vlerësuar me 11 pikë më shumë kandidatin R2.
17. Komisioni vlerëson se, kandidati R2 ka paraqitur aplikacionin për licencë të KPM-së më të detajuar dhe më të qartë, duke e mbështetur edhe në dëshmi të qëndrueshme për të themeluar një radio stacion që do të jetë në shërbim të qytetarëve të komunës së Gjilanit.
18. Kandidati R2 ka ofruar materiale të nevojshme dhe të mjaftueshme, për të qenë në përparësi me kandidatin R1, për t'u pajisur me Licencë të KPM-së, duke vepruar në pajtueshmëri me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së, si dhe me konkursin publik për frekuenca të lira, të shpallur më 14 prill 2016, nga KPM.
19. Komisioni vlerëson se, kandidati R2 ka përmbushur kriteret kualifikuese për t'u pajisur me licencë të KPM-së, në pajtim me Ligjin e KPM-së, me Rregulloren KPM-2013/04, duke grumbulluar gjithsej 89, pikë për sa i përket plotësimit të kriterëve profesionale për licencë të KPM-së, në pajtim me Rregulloren e KPM-2014/01.
20. Vlerësimi i aplikacioneve është bërë mbi bazën e metodës krahasuese, duke u bazuar në aplikacionin më të kompletuar në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.

Vendim

21. Komisioni, në takimin e mbajtur me datën 30 qershor 2016, merr VENDIM që kandidatin R1 t'ia REFUZOJË kërkesën për licencë të KPM-së, mbi bazën e pikëve të grumbulluara (78 pikë) gjatë vlerësimit të aplikacionit.
22. Komisioni, në takimin e mbajtur me datën 30 qershor 2016, merr VENDIM që kandidatin R2 t'ia APROVOJË kërkesën për licencë të KPM-së, mbi bazën e pikëve të grumbulluara gjatë vlerësimit të aplikacionit (89 pikë), për të vepruar si shërbim medial audio, duke ofruar programe audio, me interes publik për qytetarët në Komunën e Gjilanit.
23. Me këtë VENDIM, kandidatin R2 i lëshohet licenca e KPM-së sipas kategorisë për mbulim lokal.


24. Përcaktimi i parametrave teknik si dhe caktimi i frekuencës, që do të shfrytëzohet nga kandidati R2, do të përcaktohen në Tabelën Teknike të Pakos së Licencës së KPM-së.

E drejta për Ankesë

25. Kandidatit R1, në bazë të Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave (Ligji nr. 04/L-44) i njihet e drejta e ushtrimit të ankesës ndaj këtij vendimi.
26. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkojnë nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
27. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante, të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së, gjatë marrjes së vendimit.


Lëshimi i Vendimit

28. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit të tij.


Adnan MEROVCI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



06.07.2016
datë

757

Lloji i dërgesës
Vista pošiljke

Vlera e cekur - Shuma e dërguar
Označona vrednost - poslani iznos

nën numër,
pod br.

N.S.H. "Medica F Kosova", Z. KUSHTETIM AJLAZ
për
za
Dr. Gjergj Fishta nr. 28 - PRISHTINE

(Vendi)
(Mesto)

Posthtë i nënshkruari deklaron që dërgesa e cekur (shuma e dërguar) është dorëzuar në rregull (paguar me datë)
Dole potpisani izjavljuje da je pomenuta pošiljka (poslani iznos) predata uredno (placena dana)

Nënshkrimi i marrësit
Potpis primaoca



Vula e postës së vendit
Peçat pošte



KPN

Nënshkrimi i nënpunësit
të postës së vendit
Potpis radnika pošte

VENDIM
131.7.116.